

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545



The **Albanian**

VITI I 20 I BOTIMIT 10 MAJ 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**VETËM 20 SHQIPTARË
MBËRRITËN**

ME GOMONE JANAR-PRILL 2024



PETRIT KUÇANA
VOTA E DIASPORËS
DOMOSDOSHMËRI
PËR TË SHPËTUAR
DEMOKRACINË
NË SHQIPËRI



ARBEN MANAJ

MISTERI I
TELEFONATËS
RAMA-SUNAK

KUJTIMET E
RAMAZANIT

DAUT DAUTI



ATY KU PUSHTETARËT
VJEDHIN, SHTETI U TAKON
HAJDUTËVE!

KIM MEHMETI



PRANVERA E
ANKTHIT TË VELIAJT

ANDI BUSHATI



TV SI
TIK TOK

LUTFI DERVISHI



NJË RRUË PËR NË
KUSHTETUESE DHE
KËSHILL TË EVROPËS

VETON SURROI



E ARDHMJJA FILLON TANI

Dotech
websites

JEPI FRYMËMARRJE
BIZNESIT TËND



PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TE VINI NË
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Pas përfundimit të votimeve në Shqipëri, u dëgjua nga eksponentë të ndryshëm edhe domosdoshmëria e pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhje.

Mbase për shumëkënd harta e prodhuar nga këto zgjedhje vërteton, kalimin drejt një sistemi autokratik në Shqipëri dhe nëse i referohemi raportit paraprak të OSBE Odhr-it,

VOTA E DIASPORËS, DOMOSDOSHMËRI PËR TË SHPËTUAR DEMOKRACINË NË SHQIPËRI

duket thajse e pamundur një rikthim normal në një sistem demokratik të shanseve të barabarta. Mbase është e vështirë për shumë pjesëtarë të diasporës, sidomos brezin e ri, për të kuptuar qoftë të dhënat e këtij raporti për shitblerje votash, presionin ndaj administratës për të votuar (ndryshe ju heqin nga puna), të gjendurit e të fortëve përpara qendrave të votimit, blerjen e heshtjes etj. Për pjesën tjetër të diasporës këto janë krejtësisht të qarta, ndonëse krejtësisht të pakuptueshme se si është e mundur që një qytetar, që ka pagën më të ulët në rajon, që është bombarduar me skandale të njëpasnjëshme nga

një qeveri prej mëse 10 vitesh në pushtet, nuk arrin të jetë qytetar i lirë, të paktën ditën e zgjedhjeve. Duket se diaspora ndjehet tërësisht e pafuqishme edhe kur dëgjon analistë të paktë, që shprehen vazhdimisht se antiopozitarizmi është profesioni më fitimprurës në Shqipëri dhe se nuk duhet të jesh ekonomist shumë i zoti, për të kuptuar rënien drastike historike, të kursit të euros në Shqipëri gjatë fushatës elektorale. Mbase për një pjesë të madhe të qytetarëve besohet se diaspora do ta bëjë Shqipërinë më të mire, diaspora as nuk mund të shitet e as nuk mund të blihet, e kurrsesi të shantazhohet.

Qeveria duket tejet komode në këto kushte, pasi mund të kontrollojë çdo gjë në Shqipëri, e nëse para më shumë se 10 vitesh Rama i bënte thirrje diasporës që të nxisnin familjarët e tyre për të votuar, tashmë me një komoditet të paparë, pa pyetur për rregullat minimale të demokracisë trumpeton fitoren e thirrjes së tij, për të mos shkuar në votime, në qoftë se nuk votohet për të.

Mjerisht në mëmëdhe janë prishur edhe ata ekuilibra të brishtë të tranzicionit dhe se zbrasja e Shqipërisë ka shënuar nivele rekord, por që nuk përbën asnjë shqetësim për qeverisjen apo edhe

mediat afër tij, që fatkeqësisht nuk kanë mundur të jenë në nivelin e mbrojtjes së interesave të publikut. Duhet ripërsëritur se vota e diasporës është domosdoshmëri për të shpëtuar demokracinë në Shqipëri. Talentet e diasporës duhet me patjetër të përfshihen jo vetëm në arenën politike, por në çdo fushë të jetës në Shqipëri. Investimet e diasporës duhet të shihen me përparësi dhe të gjejnë vend në kaosin oligarkik. Mbase vetëm kështu do të fillojë të ndryshojë jo vetëm mendësia, por do të fillojë të marrë formë një shtet normal demokratik, një vend që aspiron të bëhet anëtar i Bashkimit European. ribotim

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARET NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER **SPONSORSHIP LICENSE**

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Ashtu sic edhe pritej, nisur edhe nga sondazhet, laburistet e opozites britanike i kane shkaktuar nje humbje sizmike konservatoreve ne pushtet te kryeministri Rishi Sunak, ne zgjedhjet lokale te se enjtes. Shumica e vendeve te fituara dje ishin fituar nga konservatorët ne maj te 2021 kur konservatorët e Boris Johnson ishin vetem 6 pike perpara laburistëve te opozites ne sondazhet kombetare.

Ndersa sot Laburistet jane mbi 20 pike perpara te konserva-



toreve te qendres se djathte. Shume vende te fituara nga opozita jane edhe ne zonat ku kishin fituara partite pro-brexit, ne referendum.

Pas 14 vjetesh ne pushtet elektorati britanik duket i lodhur

dhe semure nga pushteti dhe deshtimet e qeverive te njepasnjeshme konservatore, dhe gjasat qe kryeministri aktual te shmang humbjen ne zgjedhjet e reja te ketij viti, jane thujse minimale.

Nese ky rezultat do perkthehej ne zgjedhjet e reja te korrikut ose tetorit, do kishim nderim kuajsh ne karrocen e pushtetit, dhe rezultati i tyre nuk eshte gje tjeter vecse nje shkelmim ne gramat e fundit te nje kali te ngordhur politik, sic jane shn-

deruar momentalisht konservatorët e kryeministri Sunak.

Mbetet te shihet nese ky rezultat do nxis nje grusht shteti brenda elites politike konsvertare per te larguar menjehere kryeministrin nga posti, apo nese ky i fundit e percepeton nje perpjekje te tille do shpall menjehere zgjedhjet e reja parlamentare te parakoshme brenda korrikut.

Cilat do qofshin levizjet pas lokaleve, ajo qe nuk ndryson eshte se sondazhet jane konsistente per hendekun mes laburistëve qe kerkojne te vine ne pushtet, dhe konsartoreve qe kerkojne te zvarriten dhe mbajne me thonje pushtetin, edhe pse e kane ate prej 14 vjesht, nderkohe qe jane ne nje grope jashtezakonsht te thelle elektorale.

HA
HARIS ALI SOLICITORS



KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

ARBEN MANAJ

Ne deklaratën e Kryeministrit britanik, 10 Downing Street pas telefonatës së Sunak me Ramen, ditën e premt, bie në sy theksimi i vecantë i luftës ndaj sfidave të emigracionit ilegal dhe presupozohet kontributi potencial i Shqipërisë, çka do diskutohet edhe në forumin nderqeveritar të krijur në 2022, i quajtur Komuniteti Politik Evropian, i cili pritet të mbahet në 18 korrik në Britani.

Por cilat janë nevojat, me shumë të Sunak për të pasur bashkëpunimin me Shqipërinë, kur nderkohe e kanë një marrëveshje bilaterale për kthimin në Shqipëri të shqiptarëve të ardhur me gomone përmes La Manshit. Padyshim që lakun në fyt nga mosfrenimi i emigrimit ilegal drejt Britanisë, e ka Kryeministri britanik Rishi Sunak, aq më tepër që është vetëm pak muaj larg nga zgjedhjet e reja parlamentare, që ai pritet të humbasë, dhe në kushtet kur vala e emigrimit përmes La Manshit nuk po frenohet, e kur plani i tij për Ruandën, duket se nuk do ketë impakt prioritar në votëdhënien e britanikeve në zgjedhjet e përgjithshme.

Rama dhe Sunak kanë nënshkruar në 2022, një marrëveshje për rikthimin nga Britania të shqiptarëve që vijnë ilegalisht, nderkohe Tirana ka nënshkruar një marrëveshje me Italinë për refugjatët e kapur në ujrat e Mesdheut.

Misteri i telefonatës Rama-Sunak



Edhe, pse të dyja marrëveshjet janë mjaft të debatueshme, me shumë me kosoto politike ende të pandjeshme për Ramen, dhe përfitime elektorale potenciale për Sunak dhe Melonin, mbetet e padëshfrueshme nga gjuha e drunjtë diplomatike se çfarë tjetër mund të ofroj Shqipëria ose të vetofroje për të frenuar me tej valën e emigrimit ilegal ekstrakomunitar përmes Evropës drejt vendeve me të begatë të veriut të kontinentit.

Në kushtet kur opoziti britanik publikisht ka deklaruar se do e varros planin e Ruandës kur të vij në pushtet, me shumë gjatë pas zgjedhjeve të këtij viti dhe kur plani i Sunak për Ruandën ende nuk po materializohet deri në korrik, kur koïncidon, edhe me takimin e 18 korrikut në Londër, Sunak përveç suksesit në rolin e mikëpritësit të takimit, ka interes mbijetues për sukses paraelektoral për ceshtjen e ndjeshme të emigrimit të pafrenueshem drejt brigjeve an-

gleze neper La Mansh.

Kur shqiptarët e ardhur ilegalisht drejt Anglisë, Rama i ka pranuar të marrë mprapsht, duke djegur sakrificat e vështiresit të tyre që kalojnë përmes vdekjes në ujrat e La Manshit drejt El-Dorados britanikë, mbetet një mister se çfarë tjetër kontribut mund të ofrojë ose të kërkojë Shqipëria në këte luftë, që vet Evropa zyrtare ku Tirana është ende në paradhome, ende i shmanget.

Nese Rama do vazhdojë si deri me sot të jetë altruisti i vetofruar apo i kërkuar i halleve migratore evropiane, kjo do mesohet në korrik ose me heret, një rol që I shmagen ta përmbushin ata që kanë me shumë obligime institucionale, si vendet anetare të BE-së, por që u heq këte barre një vend kandidat, si asnjë vend tjetër po kandidat i Bashkimit Evropian, ku Britanisë pasi doli nga Unioni, i është kthyer në një lloj karme për Brexit-in.

Princi William dekoron profesorin shqiptar Andi Hoxhaj

Andi Hoxhaj, i cili është pedagog i drejtësisë në Universitetin "College of London" është nderuar me titullin "OBE- Officer i Urdhrit të Perandorisë Britanike". Ambasadori i Britanisë së Madhe në Shqipëri, Alastair King-Smith ka uruar Hoxhajn për titullin, si dhe ka shprehur vlerësim për punën e tij.

"Dr. Andi Hoxhaj mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar më 8 maj

në Kështjellën Windsor, të mbajtur nga Lartësia e Tij Mbretërore, Princi i Ëales.

Andi Hoxhaj është emëruar si Officer i Urdhrit Më të Shkëlqyer të Perandorisë Britanike (OBE) në Listën e Nderimeve të New Year 2024 për shërbimin e tij në marrëdhëniet MB-Shqipëri," shkruan Alastair King-Smith.

Titulli OBE është çmimi i dytë më i lartë në renditjen e Urdhrit të Perandorisë Britanike (duke përfshirë titullin

kalorës/dame). Ky titull është vendosur që në kohën e Mbretit George V në vitin 1917 për shërbime në perandorinë britanike.

Tashmë OBE u jepet personalitetëve që kanë dhënë kontribute të mëdha në nivel lokal, ose puna e të cilëve ka fituar një profil kombëtar.

Njerëz të famshëm që kanë një OBE janë JK Rowling OBE, David Beckham, Frank Lampard, Keira Knightley apo Damon Albarn.



VOA

Partia Konservatore në pushtet në Britani pësoi humbje të madhe në zgjedhjet lokale të premtën, duke forcuar më tej pritshmëritë se Partia Laburiste do të kthehet në pushtet pas 14 vjetësh. Zgjedhjet e përgjithshme në Mbretërinë e Bashkuar pritet të mbahen në muajt e ardhshëm.

Laburistët fituan kontrollin e këshillave lokalë në Angli ku për dekada nuk e kanë pasur shumicën dhe patën sukses në një zgjedhje të posaçme të pjesshme për parlamentin. Nëse ky rezultat do të përsëritej në zgjedhjet e përgjithshme, kjo do të çonte në një nga humbjet më të mëdha të konservatorëve.

Megjithëse rezultatet në përgjithësi janë një parashikim i zymtë për kryeministrin Rishi Sunak, partia e tij siguroi një sukses të rëndësishëm në verilindje të Anglisë. Kandidati i konservatorëve në Tees Valley arriti të rizgjidhet, ndonëse kjo u bë me një diferencë të vogël në vota. Fitorja e Ben Houchenit, i cili zhvilloi një fushatë duke bërë akuza personale, mund të jetë e mjaftueshme për të mbrojtur zotin Sunak nga revolta e mundshme e ligjvënësve konservatorë.

Për Keir Starmerin, udhëheqësin e Partisë Laburiste, këto rezultate janë të shkëlqyera. I vetmi rezultat negativ për laburistët erdhi nga Blackburn dhe Oldham në Anglinë veriperëndimore, zona këto me popullsi të madhe myslimane. Laburistët duket se u ndëshkuan si rezultat i qëndrimit të fortë pro-izraelit në lidhje me luftën në Gazë.

Laburistët fituan zgjedhjet e posaçme në Blackpool South, në veriperëndim të Anglisë, për një vend në parlamentin britanik të mbetur bosh. Kjo zonë ishte fituar nga konservatorët në zgjedhjet e fundit më 2019, kur kryeministri i atëhershëm Boris John-

Kryetari laburist i Londrës, Sadiq Khan, siguroi të shtunën një mandat të tretë historik, duke u dhënë konservatorëve një tjetër humbje të dëmshme në rezultatet e tyre më të këqija të zgjedhjeve lokale, disa muaj përpara zhvillimit të zgjedhjeve parlamentare.

Khan, 53 vjeç, mundi me lehtësi rivalen konservatore, Susan Hall, për të shmangur shpresat e Toryve të dëshpëruara se ata mund të fitonin kryeqytetin e Mbretërisë së Bashkuar nga Laburistët për herë të parë që nga viti 2016.

Kryetari i parë mysliman i një kryeqyteti perëndimor kur u zgjodh për herë të parë atëherë,

HUMBJA E KONSERVATORËVE BRITANIKË NË ZGJEDHJET LOKALE VLERËSOHET HISTORIKE



son arriti sukses të madh në zonat që mbështetën daljen nga Bashkimi Evropian.

Në këtë garë, që u mbajt si rezultat i dorëheqjes të një ligjvënësi konservator pas një skandalit lobimi, laburisti Chris Webb siguroi 10,825 vota, ndaj kundërshtarit konservator i cili mori 3,218 vota. Kjo rënie e përkrahjes për konservatorët me 26% është humbja e tretë më e madhe që nga Lufta e Dytë Botërore. Kjo do të ishte më se e mjaftueshme për të siguruar rikthimin e laburistëve në pushtet për herë të parë që nga viti 2010.

Zoti Starmer shkoi në Blackpool për të uruar kandidatin Uebb për suksesin dhe i kërkoi Kryeministrin Sunak të shpallte zgjedhjet. Kryeministri Sunak ka fuqinë të vendosë për datën e zgjedhjeve dhe ka thënë se ajo do të jetë në gjysmën e dytë të këtij viti.

ai pritej gjerësisht të fitonte ndërsa laburistët rriteshin në shkallë kombëtare dhe konservatorët vuajnë në sondazhe.

Në fund, ai pa diferencën e tij të fitores të rritet në krahasim me garën e fundit në 2021.

"Është vërtetë një nder të rizgjedhesh për një mandat të tretë," u tha Khan mbështetësve, duke akuzuar kundërshtarin e tij konservator për "frikë".

"Ne zhvilluam një fushatë që ishte në përputhje me frymën dhe

"Ky ishte mesazh i drejtpërdrejt për Rishi Sunakun për të thënë se ne jemi të ngopur me kaosin dhe ndasitë e shkaktuara prej jush dhe ne duam ndryshim", tha ai.

Zgjedhjet e së enjtes në një pjesë të madhe të Anglisë ishin të rëndësishme në vetvete pasi votuesit vendosën se kush do të drejtojë shumë aspekte të jetës së tyre të përditshme, si grumbullimi i plehrave, mirëmbajtja e rrugëve dhe parandalimi i krimin lokal, në vitet e ardhshme. Por me zgjedhjet e përgjithshme që po afrojnë, ato po shihen nga një prizëm kombëtar.

John Curtice, profesor në Universitetin 'Strathclyde', tha se rezultatet e deritanishme tregojnë se konservatorët po humbasin rreth gjysmën e vendeve që po përpiqen të mbrojnë.

"Ne jemi ndoshta duke parë një nga

rezultatet më të këqija për konservatorët në zgjedhjet e qeverisjes vendore për 40 vitet e fundit", tha ai për 'BBC'.

Partitë e tjera, si Liberal Demokratët e qendrës dhe Partia e Gjelbër gjithashtu kanë shënuar rritje. Partia 'Reform UK', e cila po përpiqet të zëvendësojë konservatorët duke tërhequr votuesit e djathtë, arriti gjithashtu disa suksese, veçanërisht në Blackpool South, ku ishte më pak se 200 vota nga vendi i dytë.

Laburistët kanë fituar në zonat që votuan shumë për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian në vitin 2016 si Hartlepool në verilindje të Anglisë dhe Thurrock në Anglinë juglindore. Ajo mori gjithashtu kontrollin në Rushmoor, një këshill ku nuk ka fituar kurrë më parë.

Një rezultat pozitiv për konservatorët

ishte ai në Tees Valley, e cila para Brexi-it kishte qenë një bastion tradicional i Laburistëve. Sidoqoftë, përqindja e votave të konservatorit Houchen shënoi rënie për 20 përqind nga viti 2021.

Kryeministri Sunak shpreson që Andy Street do të vazhdojë të mbetet kryebashkiak i West Midlands-it. Rezultati aty shpallet të shtunën. Gjithashtu të shtunën, pritet të shpallet edhe rezultati për Londrën, ku pritet të fitojë edhe një mandat tjetër Sadiq Khan i laburistëve.

Rishi Sunak u bë kryeministër në tetor të vitit 2022 pas mandatit jetëshkurtër të paraardhëses së tij, Liz Truss, e cila u largua nga posti pas 49 ditësh pas prezantimit të një buxheti me shkurtime të taksave që tronditën tregjet financiare dhe rriti kostot e huamarrjes për pronarët e shtëpive.

Udhëheqja e saj kaotike shtoi vështirësitë e konservatorëve pas udhëheqjes të paraardhësit të saj Boris Johnson, i cili u detyrua të jepte dorëheqjen pasi u gjet faturë se kishte gënjyer Parlamentin për shkeljen e kufizimeve në zyrat e kryeministritë gjatë pandemisë së koronavirusin.

Të gjitha përpjekjet e zotit Sunak nuk kanë arritur të rrisin përkrahjen, ndërsa laburistët vazhdimisht janë 20 për qind përpara në sondazhe. Nëse rezultatet e zgjedhjeve lokale përkthehen në zgjedhje të përgjithshme, laburistët do të shënonin një fitore dërrmuese në të njëjtin nivel me atë të arritur nga Tony Blair më 1997.

Përballë kësaj humbjeje, ligjvënësit konservatorë britanikë mund të fillojnë të shqyrtojnë ndonjë kandidaturë tjetër për të zëvendësuar zotin Sunak, me shpresë se kandidati tjetër mund të ketë më shumë sukses./VOA

Kryetari i parë mysliman bën histori në Angli Laburistët fitojnë sërish Londrën



vlerat e këtij qyteti të madh, një qytet që e konsideron diversitetin tonë jo si një dobësi, por si një forcë të plotfuqishme -- dhe një

që refuzon populizmin e krahut të djathtë," shtoi ai.

Humbja vjen si një seri e rezul-

tateve të mjerueshme për kryeministrin Rishi Sunak, pasi Partia Konservatore doli e treta në renditjen e këshillave lokale pasi humbën gati 500 vende në zgjedhjet lokale të së enjtes në të gjithë Anglinë.

Me Laburistët që morën fitore të mëdha, konservatorët humbën garat e vështira për kryetar bashkie në Manchester, Liverpool, Yorkshire si dhe në kryeqytet dhe gjetkë.

FESTIMI I PASHKËVE ME SHKOLLËN SHQIPTARE TË PROGRAMIT SHPRESA

AMINA MESHUNI

Atmosfera në Shpresa Programme po ziente plot jetë, një furi ngjyrash dhe krijimtarie mbushnin ajrin teksa Shkolla Shqiptare u rigjallërua me të qeshura dhe biseda të artistëve të vegjël. Me një entuziazëm që u shihej në sy dhe me lapsat e ngjyrave në duar, fëmijët ndërmorën një udhëtim plot imagjinatë dhe shprehë, duke sjellë në jetë vizionet e tyre me çdo vijë të hedhur.

Tavolinat janë shtruar me fleta akull të pastra, telajo boshe që presin preken jetëdhënëse të frymezimit rinor. Me çdo lëvizje të kyçeve të tyre, fëmijët i jepnin jetë krijimeve të tyre, me fytyrat që ndrisnin nga përqëndrimi e gëzimi. Është një simfoni ngjyrash, një kaleidoskop nuancash që kërcejnë pergjatë fletës në një festë të shpirtit rinor.

Teksa orët fluturojnë, kryeveprat e fëmijëve fillojnë të trajtësohen—vija të prera të kuqërremta, të verdha e blu ndërthuren për të për të formuar peizazhe, kafshë dhe fomra abstrakte që reflektojnë thellësitë pakufi të

imagjinatave të tyre. Me çdo pikturë të përfunduar, një kor brohorimash shpërthen, e shoqëruar me të thirrura

“Gëzuar Pashkët!”—urimi tradicional shqiptar për Pashkë—që mbush dhomën me një ndjenjë vllazërie e gëzimi.

Por s’është vetëm në lidhje me artin, është në lidhje me rrugëtimin—proçesin e krijimit që na bashkon e na kujton bukurinë që fshihet në secilin prej nesh.

Teksa fëmijët prezantojnë me krenari punimet e tyre me njëri tjetrin, një ndjenjë krenarie dhe arritjeje mbush dhomën, duke i lidhur së bashku në këtë moment triumfant.

Dhe teksa ditës i vjen fundit dhe fëmijët ndahen me krijimet e tyre shumëngjyrshë, marrin me vete jo vetëm një punim artistik, po një kujtim—një kujtim i të qeshurës dhe shoqërisë, i krijimtarisë dhe shprehisë, dhe i lumturisë që bëhet e mundur duke u mbledhur së bashku.

Gëzuar Pashkët o fëmijë të dashur të Shkollës Shqiptare të Shpresa Programme!



Paçi Pashkë të mbushur me të qeshura, dashuri e krijimtari të pa fundme. Dhe ua ndriçofshin jetët edhe ndarë lumturi e frymëzim kudo që shkoni.

Diskutimi për mënyrën sesi sistemi ynë i emigracionit është armiqësor ndaj njerëzve në rrugën e tyre drejt nënshitetësisë.

Në një takim në shtëpinë e Qytetarëve të Veriut të Londrës në Mbretërinë e Bashkuar, atmosfera ishte e ngarkuar me përvoja të përbashkëta të frustrimeve dhe vendosmërisë, ndërsa individët treguan sfidat që përballojnë refugjatët dhe kërkuesit e azilit në rrugët e tyre drejt nënshitetësisë. Ndër dëshmitë e rëndësishme të ndara, një përvojë e tmerrshme e një nëne dallohet: “Një nënë ndau përvojën e saj të tmerrshme të nevojës së padurueshme për ndihmë mjekësore për fëmijën e saj. Në mënyrë tragjike, statusi i saj imigracioni e la atë në borxh me NHS nga shtatzënia e fëmijës tjetër, duke e bërë atë të padeklarueshme për fonde publike. Ballafaquar me borxhe të pashmangshme të shtuara nga tarifat e tepruara të statusit të nënshitetësisë, shëndeti i familjes së saj është në buzë të greminës, gjë që thekson padrejtësitë e thella me të cilat përballen refugjatët në navigimin e sistemeve shëndetësore.

Një dëshmi tjetër jehoi të njëjtat përvoja të përbashkëta të kërkuesve të azilit, me familje që detyrohen të marrin vendime të rënda: “Familjet

ballafaqohen me vendime të rënda, detyruar të zgjedhin mes fëmijëve të tyre për të vendosur kujt t’i japin nënshitetësinë, duke shpresuar me padurim që njëri do të arrijë të jetë në gjendje të kujdeset për tërë familjen. Është një barrë që asnjë familje nuk duhet ta mbajë, shtypur nga pesha e pasigurisë dhe presionit të vazhdueshëm për të siguruar një të ardhme më të mirë.” Refugjatët dhe kërkuesit e azilit hasin në një varg sfidash në rrugën e tyre drejt marrjes së nënshitetësisë. Burokracitë ligjore dhe administrative, duke përfshirë procedurat e gjata të azilit dhe navigimin e sistemeve të panjohura ligjore, e shtojnë vështirësinë e tyre. Barrierat gjuhësore dhe kulturore pengojnë komunikimin dhe integrimin, ndërsa aksesit i kufizuar në shërbime bazike si shëndetësia, arsimit dhe strehimi i lë ata akoma më shumë të pambrojtur.

Sfidat e punësimit dhe ekonomike vazhdojnë, me mbështetje minimale dhe shumë pak burime të disponueshme, duke lënë shumë në një gjendje limboje pa të drejtën për

TAKIMI I SHTËPISË SË QYTETARËVE TË VERIUT TË LONDRËS NË MBRETËRINË E BASHKUAR



të punuar ose mbështetur në fonde publike.

Trauma psikologjike, stigma shoqërore, dhe ndarja familjare shtojnë shtresa të kompleksitetit në rrugën e tyre të vështirë. Refugjatët pa shtetësi përballen me vështirësi shtesë, pa të drejtën për t’u ankuar kur aplikacionet për nënshitetësi refuzohen dhe me pak status ligjor ose të drejta.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon një

përgjigje të kompletuar dhe të koordinuar nga qeveritë, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile, dhe komunitetet lokale. Përpjekjet duhet të përqendrohen në dhënien e aksesit për mbrojtje dhe shërbime ligjore, promovimin e integritit social, ofrimin e mbështetjes psikosociale, lehtësimin e integritit ekonomik, luftimin e diskriminimit dhe ksenofobisë, dhe advokimin për të drejtat e refugjatëve në nivelet

kombëtare dhe ndërkombëtare. Përballë sfidave, përvojat e përbashkëta të frustrimeve shërbejnë si një katalizator për veprim kolektiv dhe frymëzojnë individët për t’i dhënë hov përpjekjes për ndryshim dhe për të krijuar një sistem emigracioni më përfshirës dhe me më shumë kosnideratë për secilin çështje.

AMINA MESHUNI

VETËM 20 SHQIPTARË MBËRRITËN ME GOMONE JANAR-PRILL 2024

Vala e madhe e mbërritjes së shqiptarëve me gomone gjatë 2022 u përdor nga ish sekretarja e punëve të brendshme Suela Braverman, për retorikë politike në parlamentin anglez, me doza të forta antishqiptare.

Dy vite më pas panorama e shqiptarëve të mbërritur me gomone sipas shifrave të Home Office, është e papërfillshme krahasuar me nacionalitetet e tjera.

Nëse në 2022 mbërritën me gomone 13,700 shqiptarë, një vit më pas numri shkoi në 900.

Top Channel ka mundur të sigurojë të dhënat e atyre që mbërritën me gomone gjatë periudhës Janar-Prill 2024. Nga 8.000 persona që kaluan Lamanshin me gomone gjatë këtyre katër muajve, prej tyre vetëm 20 ishin shqiptarë.

Një shifër e papërfillshme për autoritet britanike duke e kthyer Shqipëri nga retorika antishqiptare e Suela Braverman në një rast suksesi se si parandalohet emigracioni ilegal,



i përmendur gjerësisht prej kryeministrit Rishi Sunak.

Tre janë faktorët se përse shqiptarët i

kanë thënë lamtumirë mbërritjes me gomone në ishullin anglez.

Së pasi marrëveshja mes dy qeverive në Londër që mori bekimin e Rishi Sunak dhe Edi Ramës në Mars 2023.

Së dyti ndryshimi ligjit të emigracionit, ku Shqipëria u vendos si një vend i sigurt pa të drejtë azil kërkimi.

Së treti, numri në rritje nga viti në vit i shqiptarëve të dëbuar me fluturime charter të përjavshme Angli-Shqipëri.

Shifrat e siguruar nga Top Channel tregojnë se për periudhën Mars 2023-Mars 2024 janë dëbuar nga Angli 5,976 shqiptarë pa leje qëndrimi përfshi ata që përfunduan dënimet në burgjet angleze.

Shifrat e Home Office tregojnë se gjatë 2023 u dëbuan 2,419 ndërsa në 2022 numri ishte 1,940. tch

BRITANIA E MADHE DO TË VOTOJË PRO KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

Nëns sekretari parlamentar i Shtetit, David Rutley, konfirmoi të enjten se Britania e Madhe do të votojë pro anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, pavarësisht se disa shtete të QUINT-it duan që vendi i vogël ballkanik të lëvizë në mënyrë të shpejtë dhe të pakthyeshme drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe përpara vendimit final.

“Unë mund t’ua konfirmoj kolegëve se Britania e Madhe do të votojë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës”, deklaroi Rutley gjatë një debati parlamentar mbi situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Në prag të vendimmarrjes historike për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, shtetet kryesore evropiane sikurse Gjermania, Franca dhe Italia, dërguan sinjale se do ta kushtëzojnë mbështetjen për Kosovën me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Shefja e Komitetit për Punë të Jashtme në Parlamentin e Britanisë së Madhe, Alicia Kearns, duke folur mbi



sugjerimet që themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë

Serbe të jetë kusht për Kosovën drejt avancimit të ardhshëm, theksoi se për

anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë të rëndësishme nuk duhet të

jetë parakusht themelimi i këtij mekanizmi.

“Disa kanë thënë se Kosova duhet të pranohet në Këshillin e Evropës vetëm nëse krijon njëfarë asociacioni. Britania e Madhe duhet ta kundërshtojë këtë. Derisa unë nuk dua një tjetër Republikë Serbe në Ballkanin Perëndimor, një asociacion do të themelohet si pjesë e dialogut Prishtinë-Beograd. Por nuk duhet të nxitohet dhe nuk mund të vijë nën presion të jashtëm”.

Kosova u mbështet nga shumica dërrmuese e deputetëve në Asambleenë e Parlamentare të Këshillit të Evropës për të kaluar fazën e parafundit drejt anëtarësimit në panteonin e kombeve të barabarta demokratike evropiane, ndërsa vendimi përfundimtar është në dorën e Komitetit të Ministrave që pritet të mblidhet në mes të majit në Strasburg të Francës.

NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN

MBI 1 000 000 NDJEKES

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në Google?

Dotech
website 

Our Services:

- Business Cards
- Logos
- Banners
- Video Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI NË ZYRAT TONA



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**



BIRN: SHQIPËRIA PO PLAKET, POR VENDI MBETET JOMIQËSOR NDAJ MOSHËS SË TRETË

Qindra pensionistë në Durrës nuk kanë mundësi çlodhjeje dhe argëtimi, ndërsa ata vetë ndeshen me probleme të mbijetesës financiare.

Shumica e të moshuarve të qytetit mblidhen çdo ditë në lulishten para godinës së Postës, aty ku disa dekada më parë ngrihej merkato e vjetër e qytetit bregdetar. Në pranverë gjelbërimi e mbulon hapësirën, por aktualisht mungon shumica e stolave të lulishtes.

“Këtu duhet të sjellësh gjithçka me vete, nga gurët e shahut e deri te stolat për t’u ulur,” tha Sami Veliu për BIRN.

Ai shtoi se që kur ka ardhur nga Skrapari në Durrës – para 20 vjetësh, në këtë lulishte e kalon kohën.

“Pensionin e kam të ulët dhe nuk ma mban të hyj e të shpenzoj në kafene”, shtoi ai.

Rrugicat e lulishtes pas orës 9 të mëngjesit mbushen me të paktën 10-12 grupe burrash që luajnë domino, shah apo me letra. Sipas Samiut mjaft prej tyre dalin edhe pasditeve.

“Janë më shumë se 50 – 60 vetë, që të gjithë të moshuar, të cilët e kanë gjetur si kalim kohe këtë vend,” tha ai.

“Por fatqësisht, jo vetëm që nuk ka një vend të mbuluar për stinën e dimrit, por edhe një banjo mungon – shtoi Sami Veliu, i cili është kritik me institucionet vendore.

Sipas Samiut, bashkia mund të krijojë edhe një strukturë prej druri, si ajo që ka ndërtuar prej kohësh Pogradeci në breg të liqenit për pensionistët e tij.

Jo të gjithë gjejnë mundësinë për të luajtur, dhe tifozët janë më të shumtë pranë tabelave të shahut, ku gara e përditshme është edhe më e fortë.



Shumica ulen në bordurat e çimentos, me nga një copë kartoni nën vete.

Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, INSTAT, moshja mediane në Shqipëri u rri nga 33-vjeç në vitin 2011, në 38-vjeç në vitin 2022. Por ndërsa vendi po plakët, strukturat e pushtetit vendor vazhdojnë t’i kushtojnë pak vëmendje hapësirave rekreative për moshën e tretë.

Lulishtja para Postës është i vetmi vend ku mblidhen pensionistët durrsakë. Tre kilometra më tej, në lagjen 18 në Spitallë ndodhet një banesë 1-katëshe, e ndërtuar ngjitur me

kanalin e ujërave të larta.

Një sallë e madhe, me sipërfaqe gati 80 metra katrore është thujse e braktisur, por edhe këtu të moshuarit nuk mungojnë. Ata luajnë të gjithë në prag të banesës, së cilës i mungon porta kryesore.

“Ka më shumë se tre vjet që ne i nxjerrim tavolinat jashtë, pasi na thanë se ndërtesa është privatizuar,” tha për BIRN Myslim Abazaj.

“Kemi biseduar edhe me drejtuesit e bashkisë për pronësinë e saj, por askush nuk na thotë diçka të saktë,” shtoi xhaxha Myslimi.

Kjo banesë është ngritur 10 vjet më parë dhe që nga dita e parë shfrytëzohet vetëm nga të moshuarit. Në faqen e internetit të bashkisë, jepet informacion për Qendrën Ditore të Moshuarve brenda në qytet, ndërsa mungojnë të dhënat për godinën që ndodhet përballë shkollës 9-vjeçare “Naim Babameto” në Spitallë.

Edhe në godinën e Spitallës mungon instalimi i ujit, e njëjloj nuk ka as banjo. Të moshuarit për nevojat e tyre detyrohen të shkojnë në lokalet pranë apo edhe në shtëpi, kur ato nuk janë larg.

Pensionistët janë të shqetësuar për të

ardhmen e Qendrës, ku ata mblidhen prej vitesh.

“Spitalla është e mbushur me familje që erdhën pas viteve ’90 nga zonat rurale të vendit, dhe të ardhurat nga pensionet i kemi mjaft të të ulta,” tha Nazmiu, i cili ka jetuar më parë në Librazhd.

“Kur kemi një vend se ku të mblidhemi gjatë ditës, familjarët tonë janë shumë më qetë”, shtoi 76-vjeçari.

Në anën tjetër të qytetit, në lagjen nr 1, Dilaver Barushi, i ka shfrytëzuar ditët e para të diellit në det.

Me Xhinën, qenushin e tij të pandarë, ai e ka gjetur bregdetin si vendin më të mirë për të kaluar kohën. Telashi i vetëm i Kavijes, siç e thërrasin miqtë, është vendosja e çadrës.

“Plazhi publik, ku lahemish prej disa vitesh u zu nga dikush tjetër, dhe ne nga halli kemi zënë vend në shkallët e Sfinksit,” tha për BIRN Dilaver Barushi.

“Këtu luajmë tavell e shah, e po ashtu këtu hyjmë në ujë për të notuar,” shtoi ai.

Të moshuarit, që vijnë me biçikleta edhe nga lagje të tjera të qytetit bregdetar, e ndjejnë vehten me fat që kanë ujin pranë. Sidoqoftë, nëse do të kishim plazhin publik, do të shfrytëzonim edhe rërën, thonë ata.

“Sfinksit” është i gjithi prej çimentoje dhe nuk rrimë dot rehat,” përfundoi Dilaver Barushi.

ALFRED LELA

REZOLUTA E RAMËS: 1604 FJALË DHE ASNJË KUPTIM

Në 1604 fjalë të tekstit të Rezolutës së grupit parlamentar socialist, lexo Edi Ramës, nuk gjendet as edhe njëherë për be fjala ‘zgjedhje’.

Pikërisht te kjo kujë e ka varur komunikimin publik, me të drejtë, opozita e vendit që prihet nga Sali Berisha.

Një tjetër kalë beteje i opozitës ka qenë dhe mbetet shpopullimi, ikja masive nga Shqipëria e rreth 1 milion shqiptarëve, duke iu referuar këtu statistikave që vijnë nga organizata të huaja, pa lidhje me opozitën apo verbin e saj politik.

As kjo fjalë, në asnjë variant të saj-emigracion, ikje, eksod etj- nuk gjendet në projektrezolutë.

Ndër fjalët që gjenden aty, kumbojnë fort të tillat si ‘reforma në drejtësi’, ‘pandëshkueshmëria’, ‘integrimi evropian’, ‘lufta kundër korrupsionit’, etj. Në çdo rast, megjithë fisnikërinë që bartin në pamje të parë apo në parim, këta janë terma të boshatisur

nga kuptimi dhe e kanë humbur rëndësinë pikërisht nga stërpërdorimi dhe mosrespektimi. Rama dhe qeveria e tij janë deficitarë në të gjitha: tezagjatje e integritetit dhe parodizim i tij- ‘çelja’ disa herë e negociatave dhe koncertet shoqëruese-, sidomos lufta kundër korrupsionit, kur përdoren nga një kryeministër dhe qeveri-me një record të pahasur më parë në historinë e Shqipërisë, janë një ironi e madhe.

Pa njohur këto dy shtylla të ligjërimit opozitar, dhe kolona të rëna të funksionimit të shtetit dhe shëndetit të kombit, çdo rezolutë është një mashtrim. Fakti që si lejtmotiv i saj është zgjedhur “Shqipëria 2030”, një slogan që Rama e përdor prej disa kohësh për të transportuar në imagjinatën e publikut idenë se ai do të qeverisë deri në atë vit, përbën edhe një tallje.

Projekti për rezolutë fton opozitën pa e njohur dhe pa e kuptuar atë, madje duke e shpërfillur. Është marra-

mendëse të imagjinosh se si kandidatët e qeverisë fitojnë në bashki si Rrogozhina dhe Kukësi për shembull, në kundërshtim të plotë me logjikën. Në rastin e parë pasi ka fituar me kutinë e votive të burgut dhe me një diferencë të vogël, dhe në të dytin pas skandalit në zyrën e kryebashkiakut Gjici.

Në manualët e politikës botërore nuk ka raste të tillë kur dikë e forcon një skandal apo shkelje, në vend që ta dobësojë.

Më herët në kohë dosjet 184 dhe 339, dhe vetëm një vit më parë përfshirja e bandave të Shkodrës demonstrativisht në fabrikimin e një rezultati që i dha për herë të parë fitoren në kryeqendrën e Veriut PS, nuk spikasin në botëkuptimin e projektrezolutës.

Mospërmendja e zgjedhjeve dhe nevojës që procesi elektoral të normalizohet dhe të dekriminalizohet, lë jashtë horizontit edhe qeverinë

teknike-pse jo sipas modelit maqedon- të cilin Doktor Berisha e ka paraqitur si kërkesë prej muajsh tashmë.

Siç nuk duket askund as hija e padrejtësisë ndaj shefit të opozitës. Gjyqi politik i Sali Berishës, përveç mungesës së provave dhe fakteve, është spërkatur me ndyrësi spektakolare, ku spikasin fort “avokatja kryesisht” e caktuar nga gjykata e cila, jo rastësisht por “kryesisht” ishte një enveriste me yll, apo Irena Gjoka, që shfaqej sa në toplistën e të angazhuarve të aplikacionit të PS “Aktivistit”, sa në dosjet non grata të autoriteteve greke, apo dhe deri në konfliktin e interesit që i siguronte shkarkimi nga Presidenti Berisha në mesvitet ‘90.

Të gjitha këto qëmtime e bëjnë rezolutën e Ramës një dokument propagandistik dhe electoral, jo një përpjekje për ulje të tensionit, paqe sociale dhe politike; aq më pak një

dokument që hap rrugën për integrimin evropian apo që ngrihet kundër dezintegritimit kombëtar, çka është në fakt shpopullimi masiv.

Fakti që Ambasada Amerikane e mori seriozisht projekt-rezolutën nuk e bën atë automatikisht një dokument serioz.

Kjo mund të tregojë një dëshirë amerikane të kahershme për grand coalition, por nuk i përgjigjet realitetit, dhe aq më pak shpresës për normalitet dhe zgjidhje. Siç e thotë edhe një slogan i paradokohshëm i Partisë Demokratike “pa zgjedhje të lira, nuk ka zgjidhje”. Të gjithë ata që kanë në duar barutin e vrasjes së zgjedhjeve nuk mund të bëjnë katarsis të shumëfishitë pa filluar nga riinstalimi i një procesi të lirë dhe të ndershëm zgjedhor.

Përndryshe, rezoluta në tentativë nuk është më shumë se një lëmsh me 1604 fjalë, një babel që nuk na çon as te marrëveshja dhe as te Zoti.

Dotech
website

Porosisini BANNERIN TUAJ

**Me përmasa
të ndryshme
PVC Banners
Mesh Banners
Ofsted Banners
Design + Post**



IMPRESS EUROPE
**TRANSFORMING
SPACES & CREATING
DREAMS**

LEADERS IN
CONSTRUCTION



Our service :

- Loft Conversion
- Extension
- Kitchen & Bathroom Refurbishment
- Plumbing
- Heating
- Electricals

☎ 07479611186 🌐 www.impresseurope.co.uk

☎ 07733025619 ✉ info@impresseurope.co.uk

Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona

Adresa e zyrove:

30 Avenons Road London E13 8HT

Tel: 020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946. Mob: 078 5997 7545



DISTRICT

CONSTRUCTION

Services

DESIGN & BUILD
LOFT CONVERSION & EXTENSION
KITCHEN RENOVATION
BATHROOM RENOVATION
REFURBISHMENT
ROOFING
GARDENING
PLUMBING & ELECTRICALS
PAINTING & DECORATING



www.districtconstruction.co.uk

info@districtconstruction.co.uk

Tel: 07780941795

KIM MEHMETI

ATY KU PUSHTETARËT VJEDHIN, SHTETI U TAKON HAJDUTËVE!

Rasti i Lali Erit dhe orvatja e tij që prokurorët t'i shpallë kolegë e gazetaret armiq, shpërfaq të vërtetën se pushtetarët e fajshëm janë të mirësjellshëm, e madje edhe bamirës, por vetëm përderisa veprojnë të papen-guar. Dhe se i kthehen origjinës dhe rugaçerisë sapo i zbulojnë se nuk janë të atillë siç tregohen.

Pastaj, rasti i kryetarit të Bashkisë së Tiranës shpalosi të vërtetën se hajdutëria e politikanëve do ishte e pamundur nëse ata nuk do kishin mbulesën mediatike dhe përkrahjen e elitave që majmen e ushqehen nga hajdutëria e tyre.

Dhe Lali Eri dhe hajnat e tij tregojnë se pse shqiptarët ndjeheshin si popull pa atdhe, e hajdutët e kudondodhur të shqiptarisë mbureshin me mëmëdhe



Shqipërinë.

Sjellja e sotme e Lali Erit shpërfaq edhe dëshpërimin e pushtetarëve të

cilët gabimisht besojnë se kurrë nuk do bie dekori i rrejtshëm i 'spektaklit' mediatik që ata i fshehë nga sytë e popullit, 'spektakël' që ka për qëllim ta mbulojë hajninë dhe banditizmin e tyre, 'spektakël' që është shkatërrimtarë për popullin dhe vrasarë për ëndrrat rinore, që e fshehë të vërtetën se anëtarë më të rëndësishëm të 'Partisë së Hajdutëve' janë ata që e mbulojnë hajninë.

Pra Lali Eri tani ndjehet i tradhtuar nga të gjithë, duke filluar nga Kryeshefi i hajdutëve të 'Rilindjes' – Piktori, e deri te mediat dhe gazetaret që i ushqeu për ta shpërfaqur si mbjellës pemësh edhe pse ishte vetëm një mbjellës i mjerët gënjeshtresh.

Dhe s'ka si mos jetë i dëshpëruar nga

të gjithë ata që e shoqëronin deri sot kur u zbulua se nuk do mund të ishte gënjeshtar i suksesshëm pa mbështetjen e atyre që defilonin nëpër ekranet televizive ku shiteshin si ajka e mendimit të pavarur dhe kritikë, por duke qenë 'prostituta' të paguara shtrenjtë nga makrotë e tyre – nga Lali Eri dhe Piktori!

Dhe më në fund, vëllazëria e hajdutëve me seli te Bashkia e Tiranës dëshmoi diçka shumë të dhembshme që ka të bëjë me të gjithë ne: se o jemi popull pa elita, o kemi elita pe ndërgjegje!

Me çka edhe vonë e kuptuam se përderisa ka dele, do ketë kush ato t'i qethë dhe se, aty ku pushtetarët vjedhin, shteti u takon hajdutëve!

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

The collage contains numerous business cards for various companies, including:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Phone: 020 7470 8822.
- LEO'S BAR & GRILL**: Authentic Mediterranean Cuisine. Phone: 020 3788 7119.
- K ROOFING LTD**: New Roof-Lead Work-Flat Roof. Phone: 07927 214785 / 07477 867332.
- E&G STEELFIXING**: Steel Fixing, Fabrication, Welding, Ground Beams. Phone: 07595 575280.
- TUSHA CONSTRUCTION**: The Best of Construction. Phone: 07492 248409.
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: Loft Conversion, Home Extensions, Refurbishment and Renovations. Phone: 07788 882127.
- A&D CONSTRUCTION LTD**: 7 St Pauls Mews, Crawley RH10 1DR. Phone: 07590 008835.
- JD CONTRACTORS**: We have more than 10 years of experience in the building industry. Phone: 0786282088.
- A&O SCAFFOLDING LTD**: Contact Us. Phone: 07552585665.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION. Phone: 07491 051811.
- Our Services**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING. Phone: 07450211425 / 07727635228.
- Our Services**: Temporary Roof Systems, Gantry's and Loading Bays, Painters scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds. Phone: 07552585665.
- SERVICES**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates, Professional and experienced Scaffolders, Personalised services. Phone: 07425 7453012.
- BKB LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY. Phone: 07450211425 / 07727635228.
- MR CONSTRUCTION GROUP**: DISCOVER THE QUALITY. Phone: 07476768895.
- Construction Services**: info@erkconstruction.co.uk. Phone: 0744860704.
- MR BUILDING SOLUTIONS**: YOU DREAM IT, WE BUILD IT. Phone: +44 7828 079936.
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC. Phone: 07506 864 035.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: 9 Southend Arment Road Harchurch. Phone: 02071 129374.
- OUR SERVICES**: REPAIRMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GARDENS & FOUNDATIONS, PAVING, TILING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICAL & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, BRICKLAYING, STEELFIXING. Phone: 07450211425 / 07727635228.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



ANDI BUSHATI

Kush e ndjek rregullisht Instagramin e kryeministrit me siguri është habitur që në albumin e fotove që ai botoi nga nderimi për dëshmorët në 5 maj, ishte publikuar edhe një pozë e Erion Veliajt duke u përkulur para monumentit nënë Shqipëri.

Në përzgjedhjen aspak të rastësishme të imazheve duke sikur po tentohej të mbahej gjallë polemika nëse ai e ka shituar apo jo, delphinin e vet.

Pak ditë më parë, natyrisht jo në mënyrë të pafajshme, me një tjetër publikim të denjë për retushimet e kohëve staliniste, Rama e fshiu kryebashkiakun nga fotoja e përbashkët familjare me Ali Ahmetin.

Kjo lojë, tipike e diktatorëve, herë me përkrahje dhe herë me distancim, po mban në ankth komunikimin me publikun, që kur plasi skandali '5D', ai drejtorëve të bashkisë që grabisnin paratë e buxhetit për t'i dërguar në favor të kompanisë së tyre private.

Nganjëherë duket sikur Rama e mbështet dhe pastaj sikur ua lëshon turmave të uritura kufomën e Veliajt. Në njërin rast ai organizon një deklaratë të përbashkët të rakorduar, ku pohon se bashkohet 'me fjalë dhe presje' me versionin e Lalit, se edhe atë e kanë gënjyer vartësit, ndërsa në rastin tjetër nuk nguron të inkurajojë SPAK që 'ti nxjerrë ujin e zi' korrupsionit në bashkinë e Tiranës.

Në një vizitë në qendër të kryeqytetit ai e shmang të parin e tij nga protokollin, ndërsa në një eveniment tjetër 'e lejon' atë të bëhet pjesë e ceremonisë.

Këto rrokullisje të denja për lojërat e akthit të maleve ruse, të sjellin ndërment marrëdhënien në çift të dy prej udhëheqësve më të shquar të komu-

nizmit shqiptar, të përshkruar mrekullisht në një nga kryeveprat e letërsisë politiko-memorigjike shqiptare.

Në librin e tij, 'Vjeshta e ankthit', i biri i ish kryeministrit Mehmet Shehu, Bashkimi, tregon ditët e fundit para vdekjes së babait të vet dhe ankthit me të cilin familja perceptonte sinjalet herë negative dhe herë pozitive që i lëshonte sekretari i parë.

Një ditë Enveri e shtinte në dhë Mehmetin, duke i kujtuar se gabimet e tij nuk qenë të rastësishme dhe kur ky i fundit bindej se fati i tij qe përcaktuar, i jepte shpresë duke i rrahur krahët, pasi kontributet e tij për partinë qenë të pazëvendësueshme.

Pikërisht ajo vjeshtë ankthi e njeriut që e di se fatin e tij e ka në dorë dikush tjetër, që mund të bëjë njëkohësisht dhe shiun dhe diellin, të kujtohet kur sheh lojën e maces me miun që po torturon Erion Veliajn. Kohët dhe rrethanat janë të tjera, por plotfuqishmëria e atij që ka pushtetin të vendosë për fatin tënd ngelet e njëjta.

Natyrisht, evokimi i këtij asociacioni, sado interesante të jetë sprovat psikologjike e marrëdhënive të tiranëve me ata që kanë pranë, nuk ka për qëllim të eksperimentojë në këtë drejtim.

E vetmja ngjashmëri është ajo se në regjimet diktatoriale apo autoritare, fati i aleatëve politikë apo i kundërshtarëve, ai i vartësve apo i armiqve, nuk është në dorë të institucioneve, por pre e kalkulimeve, interesave apo kapriçove të atij që ka në dorë të luajë me të.

Kjo vërtetohet më së miri edhe në pasqyrimin që po i bëjnë mediat tona, gazetatat online dhe emisionet politike të mbrëmjes, çdo sinjali, simboli apo mesazhi që jep Edi Rama kundrejt Veliajt. Një publikim fotoje, apo e kundërta një retushim i saj, një paraqitje në krah të liderit apo shpangja prej aty, një frazë mbështetëse apo sfilitëse, kthehen në ngjarje publike.

Deri më tani, sa e sa shkrime apo emisione janë bërë, nisur nga këto in-

dicie, duke pasur si temë të vetme: a do e lëshojë apo jo Rama Veliajn? Është pikërisht ky fakt që tregon së në ç'zryrë vendoset realisht për fatin e kryebashkiakut.

Sa herë ngrihet kjo pyetje, në mënyrë gati, gati të pandërgjegjshme, qoftë mbështetësit e kësaj qeverisjeje, që janë në shumicë edhe përkrahës të zjarrtë të SPAK, qoftë ata që janë kritikë të tyre, gati instiktivisht pranojnë plotfuqishmërinë e Edi Ramës. Mafton kjo, po, po, pikërisht qoftë edhe vetëm kjo, për të kuptuar se e ardhmja e Veliajt nuk do varet as nga dosjet e prokurorëve, as nga 130 milionët e zhdukura të inceneratorit, as nga 30 milionë tenderat e Qatos, Mollës e Tushës, por nga kalkulimet e një njeriu të vetëm.

Para se të jetë një problem i drejtësisë, në një regjim si ky yni, dosja e Lalit është politike. Prandaj në këtë pranverë, ai dhe të gjithë ata që ka përreth, po qëmtojnë me ankth sinjalet kundërtëse të një loje si ajo që Hoxha bëri dikur me Shehun.

pari, vlen të jesh i saktë.

Përpjekja për të imituar modelin e TikTok, bën që televizioni të zbehet asetini e tij më të vlefshëm - besueshmërinë. Kur ndodh një ngjarje e madhe, njerëzit kërkojnë të mesojë nga TikTok por nga Televizioni më i mirë.

Beteja për vëmendje sot është e ashpër. Platformat e mediave sociale, me algoritmet e tyre janë krijuar për t'i mbajtur përdoruesit të droguar me përmbajtje që variojnë nga sublimja te qesharakja.

Në ngutin për të konkurruar, TV rrezikon të bëhet kopje e keqe e 'influencarve' që të tregojnë se si lahen duart, ku duhet të hash dhe si duhet të vishesh.

Është sikur në një fshat me shumë xherah, doktori të lerë stetoskopin dhe t'i bashkohet turmës së 'mjekëve popullorë'.

Lëreni TikTok-un të jetë tiktok dhe televizionin, televizion.

PRANVERA E ANKTHIT TË VELIAJT

LUTFI DERVISHI

Televizioni, gjyshi i medias, po përjeton krizë identiteti. Por në vend që të plakët me hijeshi, duke treguar përvonjë dhe mencecurinë, ka vendosur të imitojë TikTok-un.

Roli i televizionit ka qenë informimi, edukimi dhe argëtimi. Mesa duket ky trekëndësh nuk është më në modë. Moda janë videot virale. Dallimi mes asaj që është në interes të publikut dhe asaj që është interesante për publikun është shuar nga rendja pas shikuesve. Arsyeja? 'Këtë do shikuesi'.

Henry Ford thoshte që nëse do të pyesja njerëzit ata do të kërkonin kuaj më të shpejtë, jo makinën.

Në tregun e mbipopulluar mediatik, dhe në kohën kur kemi edhe media sintetike (prodhime të Inteligjencës Artificiale) besimi është monedha kryesore.

Përpjekja për ta kthyer TV në TikTok nuk është thjesht vetëm humbje e traditës dhe originalitetit, por edhe një mundësi e humbur.

Televizioni mund të luajë me pikat e

tij të forta duke ofruar cilësi mbi sasinë, duke krijuar përmbajtje që trajtojnë çështje komplekse - gjëra që kërkojnë më shumë se 60 sekonda për t'u kuptuar.

Nxitimi është për të prodhuar 'fast food digjital' të shijshëm për momentin, por pa vlera ushqimore. Modele të njohura të gazetarisë si

BBC-ja shërbejnë për të treguar se misioni i tv-se është raportimi i përgjegjshëm, edukimi, argëtimi, humlumi, analiza e thelluar dhe kontekstualiteti. Më shumë se të jesh i

TV SI TIKTOK



NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

DAUT DAUTI

Syfyri

KUJTIMET E RAMAZANIT

Me ardhjen e natës së parë të Ramazanit, njerëzit i hapnin dyert e oborreve. Dyert rrinin hapur ditë e natë dhe mbylleshin vetëm pas përfundimit të Bajramit. Kapixhikët që lidhinin oborret e fqinjëve, majtas - djathtas, gjithmonë mbaheshin hapur për shkak se qarkullimi me fqinjët ka qenë i madh dhe i pa paralajmëruar. Kështu ka qenë në shumicën e lagjeve të vjetra të qytetit. Me zgjerimin e qytetit, kjo gjë u harrua.

Netët e Ramazanit sillnin një gjallëri të pazakonshme. Shtoheshin lëvizjet e njerëzve që vizitonin njëri tjetrin, ata që shkonin në xhami për teravi, por më e rëndësishmja ka qenë lëvizja e fëmijëve. Edhe neve fëmijëve na shtoheshin liria e qarkullimit dhe kohëzgjatja e qëndrimit jashtë shtëpisë. Gjatë këtyre netëve tuboheshim nën dritën e ndonjë shtylle elektrike dhe vazhdonim me lojërat tona.

Gjallëria pushonte para mesnatës kur fillonte koha e gjumit. Mbretëronte një qetësi përrallore sa që mund të dëgjohej lehja e qenëve nga lagjja tjetër ose edhe ndonjë krismë e enëve të fqinjëve që ishin vonuar me larjen ose radhitjen e tyre nëpër kredenaca. Befas dhe në mënyrë agresive qetësinë e prishte tupanxhiu kur e lajmëronte zgjuarjen për syfyri. Krisma e tupanit vinte nga larg. Tupanxhiu, së pari fillonte ta rrihte tupanin me atë thuprrën e hollë. Herë pas here, për t'ia shtuar dramaticitetin punës së tij, e përdorte atë thuprrën e trashë që njerëzit e qanin guxha e tupanit. Sa më shumë që afrohej tupanxhiu, krisma e tupanit bëhej më e madhe.

Kisha dëshirë ta shihja tupanxhiun, por asnjë herë nuk e kam parë gjatë punës së tij për syfyri. Por, unë e dija kush ishte tupanxhiu. Ai ka qenë Demiri, një jevg që fliste bukur shqip



dhe që në kokë kishte plis. Demirin e njihnim nga dasmat. Madje, ai ishte edhe kryesori në shoqërinë kulturo-artistike (folklorike) të qytetit. Pa Demirin dasma, koncerti dhe Ramazani nuk mund të mendohejshin.

Pastaj, tupanxhiu vinte edhe një herë gjatë asaj nate. Kësaj radhe për të lajmëruar se njerëzit duhej ta lenin bukën dhe të përgatiteshin për agjërim dhe kthim të sërishëm në gjumë. Për ne fëmijët, syfyri e kishte një aspekt problematik. Kishim dëshirë të madhe të zgjoheshim dhe të hanim me të mëdhenjtë. Aroma e ushqimit të syfyrit ka qenë e veçant. Njerëzit hanin në heshtje dhe nxitonin më shumë se vakteve tjera. Kur dikush ngrihej i pari nga tërvesa, dëgjohej një zë: 'ha edhe pak se dita osht e gatë' ose 'pije edhe ni tas ujë se iftari osht larg'. Kur ne nuk zgjoheshim për syfyri, me apo pa fajin tonë, të nesërmen na

ngushëllonin me shprehjen irlituese: 'T'kemi thirrë, po nuk je çu'. Pësja e ironisë së kësaj thënie ka qenë e rëndë nëse nuk shndërrohej në humor.

Iftari

Ramazani sillte ndryshime rrënjësore në jetën e përditshme në shtëpitë tona. Ndryshonte orari i ngrënies dhe kualiteti i ushqimit. Në përgjithësi ramazani sillte një atmosferë elektrizuese në mesin tonë. Para fillimit të këtij muaji ne i zotoheshim njëri tjetrit, por edhe prindërve tanë, me qëllim që t'i impresiononim, duke u deklaruar publikisht se sa ditë do t'i agjëronim. Me gëzim të madh i hynim garës që nga dita e parë. Sikur në atletikë, agjërimi i ngjante garës së vrapimit rreth stadiumit të cilit duhej

t'i sillleshim 30 herë rreth e përqark. Sikur atletët e papërgatitur, dikush dorëzohej që në rrethin e parë, dikush në të dytin apo në të tretin dhe gati askush nuk i arrinte t'i kalonte 30 rrathët. Pasi që Ramazani në atë kohë vinte gjatë dimrit, ditët ishin të shkurtëra, dhe askush nuk kalonte pa agjëruar së paku tri ditë të Netëve të Mëdha.

Gjatë këtij muaji, puna jonë e përditshme ka qenë pritja e iftarit. Dilnim në një vend nga ku dukej minarja e Xhamisë së Madhe të qytetit dhe pritnim ndezjen e kandilave që krijonin rrethin e sherifes në minare. Vendi i pritjes ka qenë një tumë rrëzë disa plepave që gjendeshin për skaj lumit. Tuma, që ishte krijuar nga dikush pasi kishte hedhur një sasi të dheut, që i kishte tepruar nga materiali ndërtime, qëndronte në mes dy - tre plepave, aty ku do të duhej të ishte

trotuari në vendet e urbanizuara. Por, urbanizimi i lagjes tonë erdhi më vonë se në lagjet tjera që formonin qendrën e qytetit.

Në drejtim të minares, ku ne i mbanim sytë prore, kanë qenë dy ndërtesa, njëra njëkatëshe dhe e gjatë kurse tjetra trekatëshe. Sado që kjo trekatshja kishte shkuar lart, nuk ia mbulonte minares as gjysmën e trupit të hollë. Këto kanë qenë banesa të shtetit që dukeshin bukur dhe të ndërtuara sipas standardeve moderne. Në to banonin diku rreth 10 familje, që kishin punë shteti, nga të cilat dy apo tri kanë qenë shqiptare kurse tjerat serbe. Kjo ka qenë një lloj oaze dhe aty Ramazani nuk shkonte. Ramazani ishte për ne, shumicën e qytetit të gjysmë urbanizuar apo diku edhe të paurbanizuar.

Kur muzgu ia zbehte pamjen minares, ne ndjenim se po afroheshim momentet e fundit dhe vëmendjen, së bashku me shikimin në drejtim të minares, e përqendronim në maksimum. Kur ndizeshin kandilat, të gjithë kërcenim nga vendi dhe lëshonim një bërtitme të thekshme: Iftaaaaa. Kjo bërtitme ishte si një krismë e hollë dhe shurdhuese, që dilte papritur nga gryka e ndonjë pushke. Duke bërtitur lëshoheshim pa kujdes nga degët e plepave dhe nga tuma e nisheshim xhadesë teposhtë dhe hynim në sokakun ku i kishim shtëpitë. Nga dera e oborrit deri te ajo e shtëpisë vrapim shpejtohej së bashku me frymëmarrjen dhe të rrahurat e zemrës. Mezi ndaleshim në hajat, merrnim frymë dhe, edhe një here bërtitnim 'iftaaaa'. Ndjehehim të rëndësishëm dhe sikur që kërkonim shpërblim që në shtëpi e sollëm lejen për të ngrënë - iftarin.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 

Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



Akoma nuk keni një website?

MUND TE VINI NË ÇDO KOHE NË ZYRAT TONA

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

- ✓ BUSINESS CARDS
- ✓ BANNERS
- ✓ LOGO
- ✓ POSTERS
- ✓ VIDEO MARKETING

The Albanian

OFERTA
SPECIALE

Dotech
websites 

KONTAKTONI

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545





**OFERTA
SPECIALE**



AHMET RUBBISH CLEANING

- HOUSE CLEARANCE
- OFFICE CLEARANCE
- RUBBISH DISPOSAL
- BUILDERS WASTE CLEARANCE
- WAREHOUSE CLEARANCE REMOVALS
- GARDEN CLEARANCE
- SHED REMOVAL AND CLEARANCE

**Oferta speciale per
kompanite shqiptare**



07380 493807



VOA

Rezoluta për Srebrenicën, e cila shpall 11 korrikun si Ditën Ndërkombëtare të Kujtimit të gjenocidit të kryer ndaj boshnjakëve në atë zonë gjatë konfliktit në ish-Jugosllavi, pritet të jetë temë debati dhe votimi në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Periudha në prag të debatit u përshkua me këshillime në selinë e Kombeve të Bashkuara, lobim aktiv nga mbështetësit dhe kundërshtarët e Rezolutës, si dhe deklarata të mprehta nga kritikët e udhëhequr nga rusët, përfaqësuesit e Serbisë dhe të Republikës Serbe të Bosnjës.

Deri në votim, shtetet anëtare të Asamblesë së Përgjithshme kanë mundësinë të paraqesin amendamente në tekstin e propozuar, që u hartua nga Gjermania dhe Ruanda. Udhëheqja e organizatës e ka bërë të qartë qëndrimin rreth kësaj çështjeje.

“Fakti që është kryer gjenocid në Srebrenicë, është konfirmuar nga gjykata. Sa herë që më pyesin nëse është vërtetuar, përgjigjem se po. Pra, këto fakte, për ne, nuk kanë ndryshuar. Shtetet anëtare do deklarohen për këtë sipas pikëpamjeve të tyre”, tha Stéphane Dujarric, zëdhënës i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Antonio Guterres.

Mundësia e miratimit të një rezolute me të cilën vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara do të konfirmojnë se në zonën e Srebrenicës në korrik të vitit 1995 është kryer gjenocid ndaj boshnjakëve, alarmoi një pjesë të opinionit ballkanik dhe nxiti reagimin e ashpër të zyrtarëve të Serbisë dhe Republikës Serbe. Ajo gjithashtu hasi në kundërshtim të fortë nga Rusia, një vend me të cilin Serbia dhe Republika Serbe mbajnë lidhje të ngushta politike, ekonomike dhe ushtarake. Ekspertët e shohin përpjekjen për të debatuar dhe votuar për projektrezolutën si një lëvizje simbolike, pa asnjë pasojë negative, veçanërisht pasi ajo mbështetet në fakte të konfirmuara prej kohësh në lidhje me ngjarjet e korrikut të vitit 1995.

“Aktorëve u takon ta vendosin në një kuadër që u përshtatet interesave të tyre. Unë e shoh atë si një hap drejt pajtimit, sepse do të nënkuptonte një pranim simbolik që ngjarjet në Srebrenicë paraqesin gjenocid, i cili ishte subjekt i disa vendimeve nga gjykatat ndërkombëtare. Është e qartë se disa politikanë po përpiqen ta përdorin këtë moment si një mjet për të përshkallëzuar tensionet. Megjithatë, është përgjegjësi e rezolutës apo e politikanëve.... Nuk do të pajtohe-

PSE DHE PËR KË ËSHTË E RËNDËSISHME REZOLUTA PËR SREBRENICËN?



sha që vetë rezoluta të nxisë tensione”, tha për Zërin e Amerikës David Simon, drejtor i Programit të Studimeve mbi Gjenocidin në Universitetin Yale.

Dhjetëra vende të botës kanë vendosur ta mbështesin ose bashkë sponsorizojnë projektrezolutën, përfshirë Shtetet e Bashkuara.

“(Projektrezoluta) kujton një fakt historik në një kohë kur gjenocidi mohohet gjithnjë e më shumë në rajon dhe kriminelët e luftës madhërohen. Bashkë sponsorët e saj besojnë se ka ardhur një moment i rëndësishëm për të përkujtuar atë ngjarje historike në një masë më të madhe. Vërtet nuk duhet të jetë sfida, sepse nuk veçon asnjë vend apo popull, përveç kriminelëve që e kanë kryer atë vepër”, është pikëpamja e zotit Gabriel Escobar, Zv/Ndihmës Sekretar Amerikan i Shtetit dhe i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor.

Nga ana tjetër, Rusia kundërshtoi me forcë projektrezolutën, duke kërkuar tërheqjen e saj. Në Nju Jork, në bashkërendim me Serbinë, ajo lloboi në mënyrë aktive për këtë.

“Ajo nuk mund të sigurojë pajtimin kombëtar në Bosnje dhe Hercegovinë, por vetëm mund të shtojë mosmarrëveshjet në atë vend dhe në Ballkan në tërësi. Dokumenti bart një akuzë kundër serbeve, e cila është

e qartë. Rezoluta nuk e akuzon drejtpërdrejt popullin serb, por u referohet vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, si dhe opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Srebrenicën, që vështirë se mund të quhet i drejtë në raport me serbët”, tha zëdhënësja e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova.

Në fillim të majit, me kërkesë të Rusisë, në Këshillin e Sigurimit u mbajt një seancë e jashtëzakonshme kushtuar Bosnjës e Hercegovinës, në të cilën u dëgjuan të njëjtat tone të përfaqësuesve rusë. Serbia në atë seancë përfaqësohej nga Marko Gjuric, në cilësinë e të dërguarit të posaçëm të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

“Rezoluta nuk është gjithëpërfshirëse dhe mohon drejtësinë për shumicën e viktimave të luftës. Republika e Serbisë në vazhdimësi dhe me vendosmëri ka dënuar të gjitha krimet e konfliktit tragjik, dhe veçanërisht masakrën në Srebrenicë, një ngjarje e tmerrshme që shquhet për mizorinë e saj. Në vitin 2010, Kuvendi i Serbisë miratoi një deklaratë që dënonte krimin. Dy presidentë të Serbisë morën pjesë në përkujtimet në Qendrën Përkujtimore “Potoçari” dhe përfaqësuesit e saj morën pjesë edhe në përkujtimet në Kombet e Bashkuara në Nju Jork”, tha në atë seancë Marko

Gjuric.

Beogradi zyrtar, përkundër disa aktgjykimeve të gjykatave ndërkombëtare të cilat vërtetojnë se në Srebrenicë në vitin 1995 ishte kryer gjenocid ndaj boshnjakëve, nuk e njehtësi këto dhe e karakterizon ngjarjen si një krim të përmasave masive.

Rusia, e cila po kryen agresion brutal kundër fqinjëve të saj të parë, Ukrainës për të tretin vit, mbështet fuqishëm politikën rajonale dhe qëndrimet e udhëheqjes serbe. Nëntë vjet më parë ajo bllokoi në Këshillin e Sigurimit miratimin e Rezolutës për Srebrenicën, e cila dënonte gjenocidin e kryer ndaj boshnjakëve.

“Ajo është gjithnjë e më e përfshirë në marrëdhëniet ndërkombëtare në të gjithë Evropën dhe shpesh nuk përdor kanalet e tij diplomatike për këtë, por mjetet përmes të cilave zhvillon luftën informative. Nuk dua të ndalem te akuzat ndaj saj për dezinformim, por dua të tërheq vëmendjen në nxitjen e pikëpamjeve populiste dhe nacionaliste, qëllimi i të cilave është dëmtimi i Evropës së bashkuar liberale”, nënvizon David Simon nga Universiteti Yale.

Karakterit antiserb i projektrezolutës, që do t'i etiketojë serbët dhe Serbinë si komb gjenocidal, është rrëfimi i zyrtarëve të shumtë të Serbisë, Republikës Serbe dhe Rusisë,

që kundërshtojnë debatin dhe miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Teksti i propozuar, në të cilin Zëri i Amerikës kishte qasje, nuk përmend asnjë lloj përgjegjësie të asnjë kombi apo shteti, por, ndër të tjera, bën thirrje për dënimin pa rezerva të mohimit të gjenocidit në Srebrenicë. Dokumenti dënonte gjithashtu veprimet që lavdërojnë të dënuarit për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, përfshirë ata që janë përgjegjës për gjenocidin në Srebrenicë.

“Zyrtarët si (Milorad) Dodik, ata në Beograd dhe të mos harrojmë Moskën, do të përpiqen të mohojnë faktet e vërtetuara, ose të flasin për to sa më pak të jetë e mundur. Megjithatë, e gjithë kjo tashmë është në procesverbalet gjyqësore”, thotë për Zërin e Amerikës James Gow, profesor në King's College të Londrës.

Pretendimet e Milorad Dodikut, politikanit të sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara për korrupsion dhe kërcënim ndaj tërësisë tokësore të Bosnjës se Republika Serbe mund të shpëtohet nëse rezoluta miratohet, eksperti britanik i vlerëson si teprim.

“Dyshoj se do ta bëjë një gjë të tillë, por asgjë nuk duhet përjashtuar. Nëse ai do ta bënte këtë, do të ishte një reagim i tepruar ndaj diçkaje të

mbështetur nga pjesë të qeverisë së përbashkët shtetërore në Sarajevë. Bëhet fjalë për kujtesën ndërkom-bëtare, për të cilën pres që të votohet në Asambleshë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, pavarësisht ndarjeve të mprehta. Pala që nuk e pranon mund ta injorohet, sikundër shumë aktorë që kthejnë kokën nga gjëra ndoshta edhe më të rëndësishme”, vlerëson profesor Gow.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Bosnja, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia janë ndër bashkëhartueset e projektrezolutës.

Përderisa Beogradi zyrtar e kundërshton dhe punon kundër saj, një pjesë e opinionit në Serbi nga organizata joqeveritare kundër luftës, si dhe disa politikanë të opozitës, bëjnë thirrje për pranimin dhe mira-

timin e projektrezolutës.

“E vetmja mënyrë për ta gjykuar një komb të tërë si gjenocidal është kur dikush e mobilizon atë për të mbështetur dhe lavdëruar kriminelët dhe ata që e kanë kryer atë krim. Nëse do të bëhej e kundërta, atëherë do të ishte fare e qartë; ajo që duket qartë nga gjykimet është se nuk bëhet fjalë për dënimin e një kombi të tërë”, tha për Zërin e Amerikës Olga Kavran, ish zëdhënëse e prokurorisë së Gjykatës së Hagës.

Autoritetet malazeze nuk iu bashkuan shumicës së vendeve të Ballkanit në qasjen ndaj projektrezolutës për Srebrenicën. Sinjalet e përziera dhe gjysmë informatat u shpërndanë pasi kryeministri Milojko Spajic njoftoi se Mali i Zi do ta mbështeste atë dokument në Kom-

bet e Bashkuara. Ai gjithashtu vuri në dukje se do të votohen të gjitha rezolutat që dënojnë gjenocidet dhe krimet në territorin e ish Jugosllavisë.

Megjithatë, për një pjesë të konsiderueshme të opinionit publik vendor dhe shoqërisë civile, kjo nuk mjafton.

“Besojmë se nuk mjafton vetëm votimi, sepse është edhe përgjegjësia jonë në radhë të parë për brezat e ardhshëm dhe fëmijët tanë. Kjo në mënyrë të pashmangshme nënkupton përballjen me të kaluarën, pranimin e fakteve të vërtetuara nga gjykatat ndërkombëtare dhe kombëtare. Dhe bazuar në ato fakte, ruajtja e kujtesës, mësimi për të dhe parandalimi i përsëritjes së tmerreve të tilla. Për ne ishte një çështje e padiskutueshme të prisnim që

qeveria thjesht ta pranojë”, tha për Zërin e Amerikës Tea Gorjanc Prelevic nga organizata joqeveritare “Aksioni për të Drejtat e Njeriut”.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me seli në Hagë, në një aktgjykim të vitit 2007 që pasoi padinë e Bosnjës dhe Hercegovinës kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, vendosi përgjegjësinë e Serbisë, e cila, sipas mendimit të gjykatës, nuk parandaloi dhe dënoi krimin e gjenocidit në Srebrenicë në korrik të vitit 1995, ndërsa autorët e drejtpërdrejtë të gjenocidit, thuhej në vendim, janë ushtria dhe policia e Republikës Serbe.

Me atë aktgjykim, vrasjet masive të më shumë se 8,000 qytetarëve të nacionalitetit boshnjak në Bosnjë dhe Hercegovinë u përcaktuan si gjenocid dhe u vërtetua se au-

toritetet e atëhershme në Beograd nuk kryen, nuk morën pjesë dhe nuk inkurajuan kryerjen e gjenocidit gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ish presidenti i Republikës Serbe, Radovan Karaxhiç dhe ish komandanti i Ushtrisë së Republikës Serbe, Ratko Mladiç, u dënuan me burgim të përjetshëm.

Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nuk janë detyruese, por interpretohen si dokumente me peshë politike dhe pasqyrojnë pikëpamjet e vendeve anëtare të atij mekanizmi për çështjen e përfshirë në rezolutat e miratuara./ VOA

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT


The image displays a collection of business cards for various construction and renovation services. Each card includes a QR code for easy contact and lists specific services offered. The cards are arranged in a grid-like fashion, showcasing a wide range of professional offerings in the industry.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKESIN E KOMPANISË TUAJ

POROSISNI BUSINESS CARDS

Dotech websites



Websites 01

Business Cards 02

Banners 03

Marketing 04



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

Drafti i “Asociacionit” duhet të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës si pjesë e procesit të filluar më 2013. Do të ishte fitore e dyfishtë, po qe se ky veprim është pjesë edhe e konsensusit politik në Kosovë.

VETON SURROI

1.

Prej sot jemi në muajin kur do vendosur a po bëhet sivjet Kosova anëtare e Këshillit të Evropës apo rekomandimi i Asamblesë parlamentare për anëtarësim shtyhet për shqyrtim vitin e ardhshëm; edhe më keq, vihat në votim e nuk arrin dy të tretat e nevojshme të votave për. Numri i njerëzve që janë të brengosur që kjo çështje të mos kalojë sivjet është në rritje dhe brenga është me vend: anëtarësimi në Këshill të Evropës e vë Kosovën institucionalisht në binarët e vet të natyrshëm evropianë. Për më tepër, ndihmon më tej në kulturën e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe - ndonëse bëhet për një organizatë që nuk merret me çështje të sigurisë - është një sinjal i duhur që tensionet e krijuara me vite brenda vendit kanë një kornizë më të mirë zgjidhjeje sesa barrikadat apo prania e përhershme e forcave speciale si garantues të mirëqenies së qytetarëve.

Shtyrja e anëtarësimit është një goditje ndaj identitetit ndërkombëtar të vendit, përkatësisë natyrore evropiane të tij dhe ngritjes së tij si shtet me evoluim shembullor demokratik në region.

Dhe shtyrja e anëtarësimit largon nga ne pikën e parë të synuar në Dialog: barazinë. Anëtarësimi në KiE i jep mundësinë Kosovës që të bëhet anëtare e mbi 220 konventave që hyjnë nën ambrellën e saj. Kosova me automatizëm po përfiton nga e drejta barazisë që parashikon neni 1 i Marrëveshjes Bazike. Kosova barazohet me Serbinë dhe fiton të drejtën që ta raportojë atë për çdo shkelje të këtyre konventave në raport me Kosovën. Shembulli imediat: Konventa Evropiane për Trashëgimi Arkeologjike do të na mundësonte të kthejmë artefaktet Muzeut të Kosovës që sot janë ende të mbajtura kundërligjshëm në Beograd.

Ndërsa jemi në muajin e vendimit, Kosovës po i kërkohet prej përkrasësve të saj më të mëdhenjve vende të Quintit dhe shteteve të tjera tradicionalisht përkrasëse që të “shënohet veprim përpara dhe i pakthyeshëm drejt Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe”(apo, siç kemi filluar ta quajmë prej kohësh, thjesht Asociacionit).

NJË RRUGË PËR NË KUSHTETUESE DHE KËSHILL TË EVROPËS



Do të përpiqem të përshkruaj një rrugë e cila gjendet mes dy mureve. Muri i parë është se Kosova nuk mund të bëjë veprime, sepse Asociacioni është pjesë e negociatave të ndërlikuara të lehtësuara nga BE, negociata të cilat nuk kanë një Marrëveshje të nënshkruar nga të dy palët (Kosova a Serbia) apo të pranuar në çfarëdo forme në tërësinë e saj. Muri i dytë është se Kosova duhet ta themelojë Asociacionin e Komunave me shumicë serbe si “pacta sunt servanda”, përmbushje e obligimeve të marra në negociata të Brukselit që nga viti 2013 e deri më sot.

2.

Së pari të largohemi prej murit të dytë.

Pra, Kosova nuk ka obligim të formojë “Asociacion” për faktin e thjeshtë se asociimi (bashkimi, bashkëpunimi, partneriteti) është e drejtë e jo obligim. Njeriu ka të drejtë të bashkëpunojë me tjetrin, ndërmarrja ka të drejtë të bashkëpunojë me tjetrin dhe njëjtë qytetet e shteteve - por në asnjë rast nuk ekziston obligimi për të bashkëpunuar. Obligimi për të bashkëpunuar është dhunim i së drejtës.

Por, ndonëse Kosova nuk mund të detyrojë komunat që të bashkëpunojnë, korniza ligjore e vendit duhet të krijojë kushte ligjore për lirinë e bashkëpunimit. Gjatë procesit Ahti-

saari dhe më pastaj Kosova ka miratuar dy ligje që rregullojnë të drejtat e bashkëpunimit të komunave, Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal. Që të dyja janë derivate të standardeve evropiane nga Karta për vetëqeverisje lokale të institucionit ku po përpiqet të hyjë, të Këshillit të Evropës.

Shtuar këtyre dy ligjeve, Kosova është angazhuar për avancime të mëtejme në negociatat e lehtësuara nga BE-ja që nga viti 2013. Pra, shtuar dy ligjeve parësore, Kosova është angazhuar dhe nuk ka finalizuar një kornizë shtesë të drejtash asociimi për komunat e banuara me shumicë serbe që duan të bashkëpunojnë mes vete.

Korniza shtesë është obligim jo si obligim që duhet të imponohet komunave me popullatë shumicë serbe, por si obligim që del si produkt i një procesi të ndërlikuar negociator.

3.

Kështu, tash mund të largohemi nga muri i parë.

Kosova ka dy ligje dhe draftte negociatore të ndryshme që dikur do të mund të prodhojnë një kornizë të drejtash shtesë për ato komuna me popullatë shumicë që zgjedhin bashkëpunim më të ngushtë mes vete. Dhe, përderisa Kosova nuk ka detyrim të formojë Asociacionin për komuna me shumicë serbe, prej vitit 2013 ka marrë detyrimin që të krijojë kornizën administrative/ligjore me të

cilën krijohet liri për të drejta shtesë që mund por jo detyrimisht duhet t'i përdorin komunat me shumicë serbe. Rrjedhimisht, Kosova nuk mund të mbështetet në murin e pritjes që procesi negociator të përfundojë; obligimi që e ka marrë për hartimin e kornizës ka qenë unilateral dhe është miratuar me dy të tretat e votave në Kuvendin e Kosovës. Për më tepër, në një interpretim më të tëholluar, pritja që Kosova të bëjë veprime të ndërtimit legjislativ të vet vetëm në fund të procesit negociator me Serbinë do të thotë se në fund do të jetë pajtimi i Serbisë ai që i jep legalitet akteve të brendshme ligjore të Kosovës apo mënyrës së ndërtimit të këtyre akteve në faza të ndryshme.

Pra, Kosova ka obligim që të bëjë dakordimin e veprimeve të veta negociatore me kornizën ligjore. Procesi i dakordimit, në Marrëveshjet e 2013 e 2015 nuk është i natyrës së verifikimit të akteve të kryera ligjore. Kështu, Kosova nuk duhet të presë që të arrihet një marrëveshje e përmbysur ligjore (si p.sh. Ligji për Asociacion, Statut i Asociacionit a diçka të ngjashme), në mënyrë që të bëjë verifikimin se a i përshatet kornizës juridike të vendit. Këtë e ka dëshmuar më 2015 kur objekt i verifikimit në Gjykatën Kushtetuese nuk ishte një draftstatut të Asociacionit, por një sërë parimesh që do ta ndërtonin atë.

Kështu, Kosova ka të drejtë që pa pritur ndonjë marrëveshje përfundimtare në procesin negociator të

Brukselit që do të përshkruajë se si mund të bashkëpunojnë komunat mes vete të bëjë verifikimin e rezultatit të deritanishëm të procesit negociator. Ai rezultat i deritanishëm, në besimin e vendeve të Quintit, është draftstatuti për Asociacionin, si një dokument zyrtar i ndërmjetësimit të BE-së.

4.

Dhe, kështu mbërrijmë te pika ku Kosova, duke u larguar prej dy mureve arrin një zgjidhje të mesme: vendi ka obligim që të hartojë një kornizë shtesë për lirinë e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ka të drejtën që gjatë rrugëtimit për hartimin e kësaj kornize shtesë të verifikojë a është ligjshëmrisht në kahe të duhur apo jo.


Meqë kemi të bëjmë me një gjendje të papërmbyllur ligjore (dekret, ligj, marrëveshje) institucioni i vetëm i cili mund të ecë tutje në zgjidhjen e mesme është Presidentja e vendit. Ajo ka të drejtë që ta dërgojë Draftin e Asociacionit në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Madje, nuk është vetëm e drejtë e saj, por është pjesë e një obligimi. Më 2015, me aktgjykimin e vet Gjykata Kushtetuese e Kosovës u shpreh qartazi për obligimin e vendit rreth hartimit të kornizës shtesë ligjore për të drejtën e bashkëpunimit komunal. Përgjatë nëntë vjetëve të kaluara institucionet e vendit nuk e kanë zbatuar aktgjykimin e Kushtetueses. Ekziston obligimi i Presidentes së vendit që të informojë rreth zbatimit të aktgjykimit të Kushtetueses së vitit 2015 dhe si pjesë e këtij informimi të dorëzimit të dokumentit i cili i është ofruar Kosovës si mundësi zbatimi të aktgjykimit. Pyetja e cila do të ngrihej në këtë proces informimi do të ishte se a mund të konsiderohej Draftstatuti i ofruar përmbushës i udhëzimeve të aktgjykimit të vitit 2015.

Presidentja e vendit bëri një hap të mirë drejt konsensusit kur i bëri thirrje BE-së që zyrtarisht t'ua dorëzojnë dokumentin e Draftstatutit udhëheqësve të opozitës në Kosovë. Hapi i ardhshëm mbase mund të ishte që t'i ftonë, t'i dëgjonte vërejtjet e tyre rreth Draftit dhe që së bashku me kryetarin e partisë në pushtet e njëherësh kryeministrin, ta dërgojë informatën konsensuale në Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për udhëzime të mëtejme juridike nga instanca më e lartë për mbrojtjen e kushtetueshmërisë.

Do të mund të ishte kurorëzimi i një procesi drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës. koha

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545